

KONTRATË DHURIMI KUOTE

Sot më datë, 24/01/2025 (dymije e njëzetepesë), lidhet kjo kontratë me qëllimin e dhurimit e kuotës që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar në shoqërinë **AnimaCon sh.p.k** nga Znj. Vjollca Hoxha te Znj. Lorela Hoxha (në vijim referuar edhe si "**Kontrata**"), midis palëve si në vijim:

- **Znj. Vjollca Hoxha**, qytetare Shqiptare, e lindur në Tiranë, më 23.03.1969 dhe me vendbanim në Rruga Fatmir Haxhiu, Tiranë, me kartë identiteti me Nr Personal G95323231L, (në vijim referuar edhe si "**Pala Dhuruese**");

dhe

- **Znj. Lorela Hoxha**, qytetare shqiptare, e lindur në Tiranë, më 19.10.1993 dhe me vendbanim Tiranë.....mbajtës i Pasaportës me Nr.Personal J36019045D në vijim referuar edhe si "**Pala Pranuese**";

(në vijim Pala Dhuruese dhe Pala Pranuese referohen bashkarisht edhe si "**Palët**" dhe veçmas si "**Pala**").

Kushtet paraprake

- Pala Dhuruese është pronar i një kuote të barabartë me 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar (në vijim referuar edhe si "**Kuota**") të shoqërisë të së drejtës shqiptare **AnimaCon Sh.p.k**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Regjistrin tregtar të QKB-së me NUIS M21803025R, me seli në Rruga "17 Nentori", Godina Nr.20, Mezez Kodër, Kashar, Tiranë, Shqipëri (në vijim referuar edhe si "**Shoqëria**");
- Kapitali Themeltar i shoqërisë është 100'000 Lek (njëqindmijë) i përbërë nga 1 (një) kuotë
- Vendimi i Asamblese së datës 23.01/2025 shoqërisë AnimaCon shpk për miratimin e transferimit të kuotave
- Pala dhuruese, Znj. Vjollca Hoxha me vullentin e saj të lirë e të plotë ka vendosur të dhurojë të gjithë kuoten që zotëron në kapitalin e shoqërisë **AnimaCon Sh.p.k**.
- Dhuruesi dëshiron të dhurojë kuotën e tij Pranuesit dhe Pranuesi i Dhurimit dëshiron të paranojë pa ndonjë kundërshtim këto dhuratë, sipas kushteve dhe termave të vendosura në këtë kontratë.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët, bien dakord si në vijim:

Neni 1

Kushtet paraprake

Kushtet paraprake të mësipërme janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të kësaj Kontrate.

Neni 2

Dhurimi i Kuotës

- 2.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate, Dhuruesi i dhuron dhe transferon Palës Pranuese, i cili pranon pa ndonjë kundërshtim Kuotën, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.
- 2.2 Titulli i pronësisë të Kuotës nga Pala Dhuruese tek Pala Pranuese transferohet me nënshkrimin e kësaj Kontrate.
- 2.3 Pala Pranuese, në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e dhuruar, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Palës Dhuruese, dhe si ortak i Shoqërisë merr përsipër detyrimet dhe pasivet e mundshme të Shoqërisë në proporcion me Kuotën e tij duke filluar nga data e kësaj Kontrate.
- 2.4 Me transferimin sipas kësaj Kontrate, kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë si më poshtë:
 - Znj. Lorela Hoxha do të zotërojë një kuotë të barabartë me **100% (njëqin përqind)** të kapitalit themeltar të Shoqërisë.



Neni 3 Çmimi

3.1 Transferimi i Kuotës parashikuar në nenin 2.1 nga Pala Dhuruese në favor të Palës Pranuese të Dhurimit do të kryhet pa kundërshtpërbllim, menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

Neni 4

Deklarime dhe Garanci të Palëve

- 4.1 Pala Dhuruese garanton Pranuesin e Dhurimit së është personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër, në emër të tij, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë.
- 4.2 Pala Dhuruese garanton Pranuesin e Dhurimit se Kuota objekt e kësaj kontrate është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, detyrim, apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.
- 4.3 Pala Pranuese deklaron se hyn në Shoqëri, në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e dhuruar, sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet. Në fakt, Pala Pranuese deklaron se pranon plotësisht situatën financiare të Shoqërisë që rezulton deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 4.4 Në përputhje me dispozitat e pikës 4.3, më sipër, Pala Pranuese pranon shprehimisht dhe pa asnjë rezervë Kuotën e dhuruar.

Neni 5

Shpenzimet

Shpenzimet ligjore dhe kontabël, shpenzimet noteriale, si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me regjistrimin e kësaj Kontrate, do të jenë në ngarkim të Palës Pranuese.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis Palëve që mund të lindin ose që lidhen me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate, do të zgjidhen në përgjithësi me mirëkuptim midis Palëve me diskutim të drejtpërdrejtë midis tyre.
- 6.2 Nëse nuk arrihet që mosmarrëveshja të zgjidhet me mirëkuptim, zgjidhja do t'i besohet eskuzivisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri.

Neni 7

Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

Neni 8

Përmbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve në lidhje me transferimin e Kuotës nga Pala Dhuruese te Pala Pranuese dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme në lidhje me të njëjtin objekt. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga të gjitha Palët.


Neni 9

Origjinalet

Kjo Kontratë është lidhur në 3 (tre) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, të gjitha të nënshkruara nga Palët.

PALA DHURUESE

Vjollca Hoxha



PALA PRANUESE

Lorela Hoxha

